

**EDUART CAKA**

**REGJISTRI KADASTRAL I PËRMETIT DHE I KORÇËS  
SI BURIM TË DHËNASH MBI GJENDJEN E SHQIPËRISË  
JUGLINDORE NË GJYSMËN E PARË TË SHEK. XV**

**Hyrje**

Vendosja e sundimit osman dhe harku kohor rreth pesëshekullor zë një vend të rëndësishëm si në historinë e Shqipërisë ashtu edhe në fushëveprimin e historiografisë shqiptare. Bazuar mbi studimet e deritanishme lidhur me vërshimet osmane drejt hapësirave të banuara prej shqiptarëve mund të thuhet se kontaktet e para i përkasin vitit 1380 kur ushtritë e tyre të drejtuara nga Lala Shahini do të sulmonin zotërimet e Gjin Zenebishit.<sup>1</sup> Pas këtij viti, ushtritë osmane do të organizojnë vazhdimisht mësymje drejt tokave shqiptare që do të vijonin gjatë viteve 1381, 1382 dhe 1384.<sup>2</sup> Në fakt, gjatë kësaj periudhe turqit i kishin shtënë

<sup>1</sup> Në këtë vit ushtritë osmane ishin thirrur prej despotit serb të Janinës, Thoma Prelubiviçit për të luftuar kundër shqiptarëve. Për më shumë të dhëna shih: Koço Bozhori, "Lufta shqiptaro-turke në veprat e historianëve bizantinë të shekullit XV", në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, nr. 3, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 380; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 320. Gjithashtu, duhet theksuar se lidhur me datën e përplasjes së parë midis shqiptarëve dhe ushtarëve turq ka edhe raste më të hershme kur në periudhën e Andronikut III ushtarët e Umur Beut kishin ardhur në pranverën e vitit 1336 drejt hapësirave shqiptare për të shtypur një revoltë të këtyre të fundit. Shih: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Iliret, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI - vitet 20 të shek. XIX), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 275; *Burime të Zgjedhura për Historinë e Shqipërisë*, vëll. II, përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1962, f. 161; Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët*, përgatiti për shtyp Ilir Ibrahim, Tiranë: Shtypshkronja KUMI, 2002, f. 127.

<sup>2</sup> J. De Hammer, *Histoire de L'Empire Ottoman*, vëll. I, Bellizard, Barthes, Paris: Dufour et Lowell, 1835, f. 249-250; Dhimitër S. Shuteriqi, *Moti i Madh, Përmbledhje Shënimesh e Dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479*, Tiranë: Dituria, 2006, f. 13-16; Selami Pulaha, "Shqiptarët dhe Beteja e Fushë-Kosovës e vitit 1389", në *Beteja e Kosovës 1389. Përmbledhje Studimesh*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2005, f. 18; Pëllumb Xhufi, "Shqiptarët e Jugut në Betejën e Fushë-Kosovës", në *Beteja e Kosovës 1389...*, f. 105; Halil İnalçık, *Kuruluş Dönemi Osmanlı Sultanları (1302-1481)*, İstanbul: İSAM Yay., 2010, f. 96-

nën zotërim prej kohësh vende e kështjella të cilat ishin të pozicionuara mbi rrugët që të çonin drejt tokave të banuara prej shqiptarëve. Siç e thekson edhe studiuesi Xhufi, marrja e Kosturit prej tyre në vitet 1384-85 u kishte hapur rrugën e avancimit drejt fushës së Korçës, e jo vetëm.<sup>3</sup> Megjithatë, depërtimi i ushtrive turke në brendësi të territorit do të ndodhte në vitin 1385 ku, si rrjedhojë e përplasjeve midis Topiajve dhe Balshajve, Karl Topia do të kërkonte ndihmën e ushtrive turke të cilat nën komandën e bejlerbeut të Rumelisë, Timurtashit do të futeshin në zotërimet e fisnikëve shqiptarë.<sup>4</sup> Kjo përleshje e madhe midis dy familjeve të mëdha shqiptare në të njëjtën kohë shënon edhe vendosjen e parë të turqve në këtë hapësirë gjeografike.

Një ngjarje tjetër e rëndësishme që kushtëzoi vendosjen përfundimtare të osmanëve në Ballkan padyshim ishte Beteja e Kosovës. Në këtë luftë të përgjakshme do të merrnin pjesë thuajse e gjithë fisnikëria ballkanase e midis tyre edhe shumë dinjitarë shqiptarë.<sup>5</sup> Humbja e koalicionit ballkanas do t'i hapte përfundimisht dyert e kësaj gjeografie për ushtritë osmane të cilat do të intensifikonin vërshimet duke arritur të shtinin në zotërim qytete e kështjella të shumta. Kështu, hapësirën gjeografike që kishin pushtuar, osmanët do ta emërtonin si

97; *Burime Tregimtare Bizantine për Historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*, përgatitur nga Koço Bozhori, Filip Liço, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, Tiranë: 1975, f. 246-247; Selami Pulaha, "Luftërat shqiptaro-turke në veprat e kronistëve dhe historianëve osmanë të shekujve XV-XVII", në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, nr. 3, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 401.

<sup>3</sup> Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII-XV*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2009, f. 311.

<sup>4</sup> Për më shumë të dhëna mbi inkursionet osmane në këtë periudhë shih: Aşık Paşazade, *Osmanoğullarının Tarihi*, Hazırlayan Kemal Yavuz, M. A. Yekta Saraç, MAS Matbaacılık A. Ş., İstanbul: 2003, f. 123; Müneccimbaşı Ahmet Dede, *Müneccimbaşı Tarihi*, Çev. İsmail Erünsal, vëll. I, Kervan Kitapçılık A. Ş., İstanbul: 1974, f. 115-116; H. İnalçık, *Kuruluş Dönemi...*, f. 98; P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit...*, f. 320-321.

<sup>5</sup> Lidhur me pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë dhe rolin që ata luajtën shih: G. Musacchi, "Historia e genealogia della casa Musachia", në Charles Hopf, *Chroniques Greco-Romanes*, Librairie de Weidmann, Berlin: 1873, f. 273; Luan Malltezi, "Beteja e Fushë-Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve", në *Beteja e Kosovës 1389...*, f. 70-77; *Historia e popullit shqiptar...*, vëll. I, f. 376; J. de Hammer, *Histoire...*, f. 281-285; Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh...*, f. 19-20; S. Pulaha, *Shqiptarët dhe beteja...*, f. 22-24; P. Xhufi, *Shqiptarët e Jugut...*, f. 110-112; *Burime të Zgjedhura...*, f. 206.

Rum-ili e cila qe një zonë administrative që do të zgjerohej në mënyrë të vazhdueshme deri në gjysmën e parë të shek. XVI.<sup>6</sup>

Të njëjtin fat me fqinjët e tyre ballkanas do të kishin edhe hapësirat e banuara prej shqiptarëve ku, menjëherë pas betejës së Kosovës osmanët do të sulmonin zonat jugore dhe juglindore të hapësirës shqiptare duke arritur të krijojnë aty edhe një formë sundimi e cila, sipas dokumentacionit arkivor por edhe të studimeve të kryera mbi këtë hark kohor, mësojmë të jetë vendosur gjatë periudhës së salltanatit të Bajazidit I. Ndër burimet më kryesore të mësymjeve osmane drejt tokave shqiptare gjatë kësaj periudhe mund të përmenden një sërë kronikash bizantine e osmane.<sup>7</sup> Në këtë kontekst, një burim i rëndësishëm që hedh dritë mbi vendosjen e sundimit osman në zonat juglindore por edhe të gjendjes ekonomike e demografike të këtyre hapësirave gjeografike në kapërcyellin e shek. XV është edhe regjistri osman i zonave të Përmetit dhe Korçës të cilin po e prezantojmë në këtë artikull.

### *I. Burimi dhe klasifikimi i regjistrit të Përmetit dhe të Korçës*

Klasifikimi i dokumentacionit arkivor ka patur një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e studimeve mbi periudhën osmane. Shtimi i punimeve shkencore ka mundësuar nxjerrjen në dritë të rezultateve të reja lidhur me aspekte të ndryshme të politikës, ekonomisë e jetës shoqërore të popujve të ndryshëm që ishin pjesë e kësaj perandorie. Botimi i regjistrit të sanxhakut të Arvanidit nën titullin *Hicri 835 Tarihli Sûret-i defter-i sancak-i Arvanid*<sup>8</sup> në vitin 1954 prej studiuesit turk Halil Inalçhik mund të konsiderohet si një gur kilometrik në zhvillimin e defterologjisë

<sup>6</sup> Në vitin 1530, ejaleti i Rumelisë përfshinte pjesën e Thrakës, Bullgarinë, hapësirën e brigjeve të Rumanisë, Moldavisë e Ukrainës, Greqinë dhe ishujt përreth, Shqipërinë, brigjet e Dalmacisë dhe një pjesë të madhe të Serbisë. Për më shumë shih: *370 Numaralı Muhasebe-i Vilayet-i Rum-İli Defteri (937/1530)*, I, Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Defter-i Hakani Dizisi: VII, Ankara 2001, f. 1.

<sup>7</sup> Mbi sulmet e osmanëve kryesisht në zonat jugore shih: *Burime të Zgjedhura...*, f. 206; Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh...*, f. 22-25.

<sup>8</sup> Halil *İnalçık*, *Hicri 835 Tarihli Sûret-i defter-i sancak-i Arvanid*, Ankara 1954. Për përkthimin në gjuhën shqipe të këtij regjistri shih: *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, përgatitur për botim nga Halil Inalçık, përkthyer nga Mykerem Janina, përkthimi i Hyrjes dhe përgatitja për botim në shqip nga Eduart Caka, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2017. Mbi regjistrin në fjalë gjithashtu shih: *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. I, f. 380-381.

në veçanti e atë të studimeve osmane në përgjithësi. Botimi i regjistrit në fjalë jo vetëm që i hapi rrugë botimeve të ngjashme si në Turqi ashtu edhe në vende të tjera të Ballkanit por, në të njëjtën kohë i parapriu edhe në aspektin metodologjik, përgatitjes së defterëve osmanë.<sup>9</sup>

Vlen të theksohet fakti se regjistri i sipërpërmendur ashtu si dhe defterë të tjerë kadastralë që janë më të hershmit e gjetur deri më sot i përkasin hapësirës gjeografike ku jetonin shqiptarët. Në anën tjetër, edhe historiografia shqiptare i ka kushtuar një rëndësi të veçantë këtyre regjistrave kadastralë duke i studiuar dhe përdorur në botimet e tyre. Këto defterë, tejet të rëndësishëm, që na dalin përpara si burime të dorës së parë lidhur me ekonominë, shoqërinë, toponiminë dhe historinë e hapësirës shqiptare duke nisur nga fillimet e shek. XV e në vijim. Brenda këtij konteksti historianët shqiptarë gjatë viteve 1960-70 arritën të përkthejnë në gjuhën shqipe një sasi të konsiderueshme kronikash e dokumentesh osmane mes të cilave edhe disa regjistra kadastralë që i përkisnin shek. XV<sup>10</sup>, prej të cilëve ai i sanxhakut të Shkodrës u botua në vitin 1974 prej studiuesit Selami Pulaha.<sup>11</sup>

Së bashku me regjistrin e përmendur më sipër ekziston edhe një numër i konsiderueshëm regjistrash të karakterit kadastral shumica e të cilëve nuk janë botuar por që i përkasin hapësirës shqiptare të shek. XV-XVI.<sup>12</sup> Gjithashtu, sërish lidhur me hapësirën gjeografike që bën pjesë në

<sup>9</sup> Ai u dha përgjigje shumë pyetjeve që kishin të bënin me llojin e timarit, pjesët e tij, ndarjet e timareve dhe aspekte të tjera të këtij sistemi. Megjithatë duhet theksuar fakti se në aspektin e botimeve të regjistrave kadastralë osmanë botimi i Inalcıkut nuk është më i hershmi. Përpara botimit të Regjistrit të Arvanidit janë realizuar edhe botime të të njëjtit karakter siç mund të përmenden: L. Fekete, *Az esztergomi szandzsak 1570, evi adoösszeirasa*, Budapest: 1943; C. C. Djikia, *Defter-i mufassal-i vilayet-i Gurcistan*, Tbilisi: 1947.

<sup>10</sup> Mes defterëve të përkthyer gjatë kësaj periudhe gjenden katër regjistra të cilat i përkasin shek. XV e që gjenden në Arkivin e Institutit të Historisë (AIH). Prej këtyre defterëve, tre janë të pabotuara. Këto janë: *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, i përkthyer prej Mykerem Janinës (i botuar në vitin 2017), *Defteri i Përmetit dhe i Korçës* (AIH, A-III-323) të cilin po e paraqesim në këtë artikull dhe që është përkthyer prej Vexhi Buharasë, dhe *Regjistri i Dibrës i vitit 1467*, të përkthyer prej Vexhi Buharasë dhe Selami Pulahës (Nahijen e Matit), (AIH, A-III-315).

<sup>11</sup> Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, Tiranë: 1974.

<sup>12</sup> Si Inalcık ashtu edhe Pulaha në hyrjet e gjata që u bëjnë përkatësisht Regjistrin të Arvanidit dhe Defterit të Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës paraqesin gjithashtu nga një listë të gjatë defterësh, të cilët u përkasin sanxhaqeve të ndryshme shqiptare e

regjistrin e Përmetit dhe të Korçës<sup>13</sup> që po paraqesim, zona të cilat duket se në kohën e këtij regjistrimi ishin njësi administrative më vete<sup>14</sup>, ekzistojnë defterë e kanunname, të cilat u përkasin dekadave të mëvonshme prej të cilave një pjesë tashmë janë botuar duke u vënë në shërbim të studiuesve.<sup>15</sup> Parë nga ky aspekt, botimi i këtij regjistri që i përket gjysmës së parë të shek. XV merr rëndësi për të kuptuar gjendjen ekonomike e shoqërore të zonës së marrë në regjistrim.

Lidhur me përkatësinë administrative të zonave të cilat janë marrë nën këtë regjistrim që po paraqesim nuk kemi ndonjë të dhënë të saktë. Me siguri dihet se këto nuk ishin pjesë e sanxhakut të Arvanidit, i cili ishte regjistruar në të njëjtën kohë me defterin e Përmetit dhe të Korçës. Në një aspekt, zonat e marra në regjistrim siç janë Përmeti, Korça, Konica dhe Grevena pozicionohen në jug dhe juglindje të sanxhakut të Arvanidit dhe duket sikur e plotësojnë atë.<sup>16</sup> Nga ana tjetër, Inalcik shprehet se në të njëjtën kohë me përpilimin e regjistrit të sanxhakut të Arvanidit ishin regjistruar edhe disa zona më të vogla si ato rreth

---

që gjenden në fondet e Arkivit të Kryeministrisë në Stamboll dhe të Arkivit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tapive dhe të Kadastrës në Ankara. Për më shumë shih: H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. V-VI; S. Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës...*, f. 3-4; gjithashtu shih: Nicoara Beldiceanu, *XIV. Yüzyıldan XVI. Yüzyıla Osmanlı Devletinde Tımar*, Çev. Mehmet Ali Kılıçbay, Teori Yay., Ankara: 1985, f. 103-106.

<sup>13</sup> Të gjitha referencat lidhur me Defterin e Përmetit dhe të Korçës të përdorura në këtë artikull janë dhënë në bazë të numrit të faqeve të të njëjtit regjistër, i cili është i daktilografuar dhe gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë, dosja me shifër A-III-323.

<sup>14</sup> H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. VI.

<sup>15</sup> Shih: *167 Numaralı Muhasebe-i Vilayet-i Rum-ili Defteri ( 937 / 1530 )*, I, T. C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, Ankara: 2003. Sërish për statusin e myslimanëve myselem të kalasë së Korçës të vitit 1530 shih: Dritan Egro, *Ligji Osman ndër Shqiptarët e Mesjetës së Vonë*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f. 194.

<sup>16</sup> Një zonë tjetër që përmendet në këtë regjistër është edhe ajo e Ashtin-ilit. Në fakt, ky toponim kalon edhe në defterin e sanxhakut të Arvanidit porse këtu kalon si Ishtin-ili. Sot është e vështirë të lokalizohet vendndodhja dhe hapësira e qartë e kësaj zone porse sipas Inalcikut kjo njësi administrative gjendej në pjesën jugore të Shqipërisë. Sipas Inalcikut, Ishtini ose Ashteni kishte qenë një fisnik i njohur shqiptar prej të cilit e kishte marrë emrin edhe zona në fjalë. Ndërsa pasardhësit e tij mësojmë të jenë islamizuar duke arritur poste të larta në administratën osmane e duke qenë zotërues timarësh. Për më shumë të dhëna shih: H. Inalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler...*, f. 148.

Përmetit, tokat e Gjonit (Yuvan-ili) dhe ato përreth Prespës (Presbe-ili). Sërish sipas të njëjtit studiues vendet e përmendura herë merreshin si të ndara e herë i lidheshin sanxhakbeut të Arvanidit.<sup>17</sup> Megjithatë, mungesa e fletëve të para të këtij regjistri përveç shumë të dhënash të tjera na fsheh edhe informacionin lidhur me emërtimin administrativ të kësaj zone të marrë në regjistrim. Sigurisht që ky konstatim vlen për kohën në të cilën është përpiluar defteri në fjalë sepse më vonë e dimë me siguri se Korça si sanxhak bënte pjesë në vilajetin e Manastirit,<sup>18</sup> ndërsa në vitin 912 Hixhri (1506-1507) vërejmë se Përmeti së bashku me Gjirokastrën, Tepelenën, Beratit, Skraparin, Kaninën e Delvinën bënin pjesë në sanxhakun e sapoformuar të Vlorës.<sup>19</sup> Për këtë arsye të gjithë studiuesit që kanë punuar mbi regjistrat kadastralë osmanë të shek. XV i janë referuar këtij regjistri si “Defteri i Përmetit dhe Korçës”<sup>20</sup> për vetë faktin se këta janë dy qendrat kryesore me të cilat nisin regjistrimet e timareve të kësaj hapësire.

Regjistri i Përmetit dhe i Korçës gjendet i regjistruar me indikacionin MAD. 231 në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Kryeministrit të Stamboll. Ashtu si një pjesë e defterëve të hershëm të shek. XV edhe ky është në përmasat 11:29 cm dhe si në llojin e letrës së përdorur ashtu edhe në shkrim ka ngjasim të madh me defterin e sanxhakut të Arvanidit. Madje, nisur nga datat e regjistrimeve, shënimet anësore, stili i të shkruarit apo dhe shenjat e tjera, Inalcik aludon se të dy regjistrat mund të jenë shkruar së bashku.<sup>21</sup> Defterit duke se i mungojnë shumë fletë si në pjesën e fillimit ashtu edhe në atë të fundit. Këtë e tregon fakti se regjistri nis menjëherë me radhitjen e disa timareve për të cilët nuk e dimë se cilës njësi administrative i përkasin për të vijuar më pas me paraqitjen e vilajetit të Përmetit. Pjesa tjetër e defterit përbëhet prej 162 faqesh prej të cilave fletët 64-67 janë boshe. Nëse do të kemi parasysh radhitjen e timareve si në këtë regjistër ashtu edhe në atë të Arvanidit, ky aspekt

<sup>17</sup> Për më shumë të dhëna shih: Halil İnalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*, I, Türk Tarih Kurumu Basımevi, Ankara: 1954, f. 159.

<sup>18</sup> H. İnalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. VII.

<sup>19</sup> H. İnalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler...*, f. 162.

<sup>20</sup> Shih: H. İnalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXI, n. 77; N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Tımar...*, f. 15; Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Akademia e Shkencave e R.P.S. të Shqipërisë, Tiranë: 1988, f. 32.

<sup>21</sup> H. İnalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXI.

tregon se defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës ka pësuar dëmtime serioze dhe ka mungesa të shumta fletësh, element ky që e pamundëson studimin e plotë të regjistrimit në fjalë.

Timaret në defterët analogë janë radhitur sipas madhësisë dhe të ardhurave ku në fillim është shënuar sanxhakbeu dhe vilajeti i tij që ndiqen nga timaret e subashit, seraskerit dhe timarlinjtë e tjerë. Ndërsa në vijim janë shënuar muafët, myselemët e vojnuket. Kjo është metodologjia që kanë ndjekur personat e autorizuar me përpilimin e regjistrimit. Për arsye të ngjashmërisë së elementëve të paraqitur në regjistrimin e këtij regjistri ixhmal (të përmbledhur) edhe përgatitja e këtij defteri është realizuar sipas metodologjisë së përdorur në përgatitjen për botim të regjistrimit të sanxhakut të Arvanidit. Të gjithë timaret e defterit janë radhitur me numra me qëllim që regjistri dhe të dhënat që ai mbart të jenë sa më praktike dhe të kuptueshme për studiuesit. Gjithashtu shënimet lidhur me fshatrat, pjesët (hisse), mevkufet ose ndryshimet që ka pësuar timari prej kohës së regjistrimit të parë janë shënuar me formën (SH).

## II. Koha e hartimit të regjistrimit dhe vlera e tij si burim historik

Faqet e para të këtij defteri për fat të keq nuk kanë arritur deri në ditët tona. Për këtë arsye është e pamundur të thuhet diçka e saktë lidhur me datën e përpilimit të regjistrimit në fjalë. Megjithatë, nga shënimet anësore, datat e regjistrimeve të ndryshme dhe ndryshimeve të bëra në regjistër dhe emrat e funksionarëve osmanë të përmendur në këtë defter është e mundur të paraqesim një datë të përafërt lidhur hartimin e tij. Nisur nga ky këndvështrim, data më e hershme që hasim në regjistër i përket muajit tetor të vitit 1431<sup>22</sup> çka tregon se procesi i regjistrimit ishte kryer në një datë më të hershme se kjo që cituam më sipër. Megjithatë, duhet theksuar se studiuesit që janë marrë me regjistrat osmanë të shek. XV japin versione të ndryshme lidhur me datën e përpilimit të këtij regjistri.<sup>23</sup>

<sup>22</sup> Shih: *AIH, A-III- 323, Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 66.

<sup>23</sup> Pulaha, i cili ka shkruar pjesën përkatëse mbi regjistrimet e para kadastrale në Shqipëri në vëllimin e parë të "Historisë së Popullit Shqiptar", Defterin e Përmetit dhe të Korçës e konsideron si pjesë të Regjistrimit të Sanxhakut të Arvanidit të vitit 1431 duke u shprehur se "kjo kopje është e ndarë rastësisht në dy pjesë, nga të cilat vetëm njëra është botuar në vitin 1954 prej historianit turk Halil Inalcık." Shih: *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. I, f. 380. Vetë Inalcıku e pranon ngjashmërinë midis regjistrave por i quan ato më vete ashtu si edhe njësitë administrative që ishin marrë në regjistrim. Shih: H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXI. Ndërsa

Ajo çka dimë tjetër me siguri ka të bëjë me faktin se defteri ishte hartuar në kohën e Sulltan Muratit II. Ky element del qartësisht në pah jo vetëm nga datat e shënimeve por edhe nga emërtimet që përdoren për sulltanët osmanë ku, ashtu si në defterin e Arvanidit edhe këtu hasim në referime të ndryshme si “sulltani i sotëm” që nënkupton Muratin II ose “sulltani i ndjerë” që në këtë rast është Çelebi Sulltan Mehmeti.<sup>24</sup> Regjistrime, ndryshime dhe shënime të ndryshme timarësh të këtij defteri kanë të shënuara cilësimet që shënuam më sipër ku spikasin një numër i madh timarësh të dhëna në kohën e Çelebi Mehmetit (1413-1421). Në defter gjithashtu hasim në disa timare të hershme të cilat janë shpërndarë që në kohën e sulltan Jildirim Bajazidit (1389-1402).<sup>25</sup> Kështu, regjistrimet në fjalë tregojnë se në disa zona regjimi i timarit që vendosur qysh në fund të shek. XIV.<sup>26</sup>

Një emër tjetër që spikat në këtë regjistër është edhe ai i Emir Sulejman Çelebiut, i cili ishte njëri prej djemve të Sulltan Bajazidit. Me vdekjen e sulltanit pas betejës së Ankarasë, shteti osman u përball me një vakuum autoriteti që u shoqërua me përplasjen midis bijve të Bajazidit në

---

Beldiceanu e jep më të vonë datën e përpilimit të regjistrit të Përmetit dhe të Korçës duke e shtyrë në vitet 1434-1435. Shih: N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Tımar...*, f. 15. Mungesa e faqeve të para të këtij defteri e lë përfundimisht të hapur diskutimin mbi faktin se këto zona përbënin një regjistër më vete apo ishin pjesë e një defteri të ndarë në dy pjesë dhe, për të dyja qasjet është e mundur të gjenden argumente. Ndarja e shumë timareve të këtij regjistri prej sanxhakbeut të njësisë administrative të quajtur Arvanid na bën të kuptojmë se mundësia që këto të kenë qenë një defter i vetëm është e logjikshme. Lidhur me vendime të sanxhakbeut të Arvanidit për ndarje të timareve në Përmet e Korçë shih: AIH, A-III- 323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 24, 28, 43, 47.

<sup>24</sup> H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XIV; N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Tımar...*, f. 14.

<sup>25</sup> Sipas Halkondilit, në kohën e Bajazidit I osmanët kishin pushtuar një pjesë të konsiderueshme të zonave jugore të Shqipërisë duke përfshirë këtu edhe Gjirokastrën. Shih: *Burime tregimtare bizantine...*, f. 326-327. E njëjta gjë përmendet edhe në *Kronikën e Janinës*. Shih: *Burime tregimtare bizantine...*, f. 249. Me sa duket zaptimet osmane me kalimin e kohës janë tkurrur duke mbetur të kufizuara vetëm me këto pjesë të regjistruara si timare të kohës së këtij sulltani. Për më shumë të dhëna shih: AIH, A-III- 323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 28, 53, 58, 73, 74, 75; gjithashtu shih: N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Tımar...*, f. 15.

<sup>26</sup> Pulaha jep vitin 1492 si datë të vendosjes së rregullt të administratës osmane në pjesën juglindore të Shqipërisë së Sotme. Për më shumë shih: S. Pulaha, *Pronësia feudale...*, f. 30; *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. I, f. 378; N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Tımar...*, f. 15.

një rivalitet ushtarak për marrjen e fronit. Emir Sulejmani kaloi në pjesën e Rumelisë<sup>27</sup> duke qenë në pozitën e sundimtarit të kësaj gjeografie për një periudhë disavjeçare. Kjo gjë del në pah edhe në regjistrin e Përmetit dhe të Korçës ku vërejmë se disa timare janë dhënë në kohën e këtij sundimtari.<sup>28</sup> Parë në këtë kontekst, ekzistenca e timareve të dhëna në kohën e princ Sulejmanit gjithashtu tregon se në këto zona sistemi i instaluar që në kohën e Bajazidit kishte vijuar pa ndërprerje deri në kohën e Muratit II, periudhë në të cilën është formuluar edhe regjistri kadastral në fjalë.<sup>29</sup>

Ashtu si në rastin e defterit të sanxhakut të Arvanidit edhe për këtë regjistër duket se hartimi dhe regjistrimi përfundimtar i timareve janë kryer në qytetin e Edirnesë, i cili në të njëjtën kohë shërbente edhe si selia ku qëndronte bejlerbeu i Rumelisë. Edhe në rastin e defterit të Përmetit dhe të Korçës, vërejmë se një pjesë e konsiderueshme e regjistrimeve dhe shënimeve të bëra në regjistër janë përpiluar në qytetin e Edirnesë, i cili në defterin përkatës përmendet gjithashtu me fjalët “qendër” apo “seli”. Qyteti në fjalë ishte kryeqendra e osmanëve deri në marrjen e Kostandinopojës në vitin 1453 por edhe më vonë do të mbetej pika më e fortë e tyre në pjesën e Rumelisë.<sup>30</sup>

Lidhur me shkaqet që çuan në kryerjen e një regjistrimi të tillë mund të jepen versione të ndryshme. Vetëm para pak vitesh osmanët kishin arritur të merrnin qytetin e Selanikut (1430), vend me një pozitë të rëndësishme ekonomike e strategjike dhe që gjeografikisht gjendej në një distancë të afërt me zonat e marra nën regjistrim. Një shkak tjetër mund

<sup>27</sup> A. Paşazade, *Osmanoğulları'nın Tarihi...*, f. 146-151; F. Taeschner, “The Ottoman Turks to 1453”, në *The Cambridge Medieval History*, Volume IV, The Byzantine Empire, Part I, Byzantium and its Neighbours, Ed. J. M. Hussey, Cambridge University Press, Cambridge: 1966, f. 768.

<sup>28</sup> Më konkretisht shih: *AIH*, A-III- 323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 51, 57, 72, 73.

<sup>29</sup> Vazhdimësia e sistemit të timarit në këto zona edhe në periudhën 1402-1413 vlen të analizohet më vete për vetë faktin se gjatë viteve në fjalë autoriteti osman në këto zona duhet të ketë qenë shumë i dobët nëse do të kemi parasysh faktin se bijtë e Bajazidit ishin në rivalitet me njëri-tjetrin për uljen në fron. Ky këndvështrim kërkon edhe më shumë konsideratë po të mendojmë se shumica e timarlinjve, siç duket edhe vetë në regjistër, ishin të krishterë. Për më shumë shih: N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Timar...*, f. 14-15.

<sup>30</sup> Shih: M. Tayyip Gökbilgin, *XV-XVI Asırlarda Edirne ve Paşa Livası; Vakıflar, Mülkler, Mukataalar*, İstanbul Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Yayınları, İsyambul: 1952, f. 6-7.

të kenë qenë edhe kryengritjet e viteve 30 të shek. XV që ndodhën në zonat e sanxhakut të Arvanidit pasi në lidhje me këto ngjarje ka shënime edhe në këtë defter siç na e tregon edhe një regjistrim i vitit H. 837 ku një fshat u është dhënë tre kështjellarëve në kohën kur “pashallarët sulmuan tokën e Shqipërisë”.<sup>31</sup> Siç duket, kryengritjet e viteve 30 të shek. XV u hapën shumë probleme sundesve të cilët harxhuan shumë energji për shtypjen e rebelimit. Këtë e vëmë re edhe në shënimet e këtij regjistri ku ata spahinj të cilët nuk kishin shkuar krahu ushtrisë për të shtypur kryengritësit do të dënoheshin duke iu marrë prej dore timaret që iu ishin dhënë.<sup>32</sup>

Përveç të dhënave të tjera mbi ndarjen e timareve, të cilat do të trajtohen në vijim, regjistri mbart rëndësi edhe mbi të dhënat që na jep lidhur me gjendjen e fisnikërisë shqiptare në periudhat e hershme të vendosjes së sundimit osman në hapësirat e banuara prej shqiptarëve. Siç dihet, shumica e familjeve të mëdha shqiptare e pranuan vasalitetin e sulltanit qysh në fundin e shek. XIV dhe fillimin e shek. XV. Ndërsa rreth mesit të shek. XV, pra rreth pesëdhjetë vite pas vendosjes së osmanëve në këto hapësira vërejmë se një pjesë e kësaj aristokracie ishte integruar në aparatën qeveritar osman duke pranuar kështu edhe besimin e ri, atë islam. Në këtë kontekst, një shembull që mund të paraqesim prej defterit të Përmetit dhe të Korçës ka të bëjë me familjen e famshme të Muzakajve, e cila zotëronte një hapësirë të madhe duke përfshirë këtu edhe pjesë të fushës së Korçës, Devollit e më tutje.<sup>33</sup> Prej kësaj familje të madhe, i biri i Teodor Muzakës mësojmë se ka ndërruar besim duke

<sup>31</sup> Bëhet fjalë për sanxhakun Arvanid porse Buharaja në përkthim e përmend si “sanxhaku shqiptar” ose “tokat e Shqipërisë”. Shih: *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 45.

<sup>32</sup> “Mbasi erdhi lajmi se Tugani nuk u paraqit me kohë në ushtri dhe nuk ka kryer deri tani as shërbimin përkatës (kullukun), iu muar timari dhe iu dha djemve të Inbekiut, Jakupit dhe Sulejmanit në mënyrë kolektive; të dy këta po e shfrytëzojnë së bashku. Në rast fushimesh të afërme, si ato kundër Shqipërisë, do të paraqiten çdo vit të dy, ndërsa në rast fushimesh në vende të largëta do të marrin pjesë me radhë.” Shih: *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 56. Po në të njëjtin defter shih edhe faqet nr. 45, 58, 106.

<sup>33</sup> Historia e familjes së Muzakajve zë një vend të veçantë për të kuptuar gjendjen e shqiptarëve dhe të aristokracisë së tyre në gjysmën e parë të shek. XV. Në rastin e defterit tonë kronika e Gjon Muzakës merr rëndësi e peshë më të madhe për vetë faktin se një pjesë e zonave të përfshira në regjistrë kishin qenë prona të kësaj familjeje. Për më shumë shih: Ch. Hopf, *Chroniques Greco-Romanes...*, f. 280-281; P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt...*, f. 441.

marrë emrin Jakup duke u ngjitur deri në funksionin e sanxhakbeut në zonën administrative të arvanidit.<sup>34</sup> Kështu në regjistrin e Përmetit dhe të Korçës gjendet një shënim i lëshuar në muajt prill/maj të vitit 1437 në qytetin e Edirnesë sipas të cilit mësojmë se Jakup Beu merr një shtesë në sanxhakun e arvanidit prej timarit të subashit të Përmetit.<sup>35</sup>

### III. Përmbajtja dhe përpilimi i regjistrit

Në kapitullin hyrës të defterit të Arvanidit, İncalcık na jep të dhëna të detajuara mbi timarin, llojet e tij, strukturën, terminologjinë dhe elementë të tjerë përbërës të këtij sistemi.<sup>36</sup> Në fakt, përcaktimi deri në detaje i secilit aspekt që ka lidhje me timarin është vendosur prej kanunaveve të nxjerra prej sulltanëve osmanë ku më e hershmja është ajo e Sulltan Mehmet Fatihut.<sup>37</sup> Gjithashtu, tashmë studiuesi ka një literaturë të hollësishme mbi sistemin e timarit, pjesët përbërëse të tij dhe aplikimin e këtij sistemi në hapësira dhe periudha të ndryshme të shtetit osman, përfshirë këtu edhe Shqipërinë ku veçojmë punimin e S. Pulahës të botuar në vitin 1988. Për këtë arsye, këtu nuk do të merremi me timarin si njësi apo si sistem, por, do të paraqesim aspekte të veçanta të aplikimit të këtij sistemi në zonat e marra në regjistrim brenda këtij defteri.

Përkundër mendimit se timari iu jepej vetëm atyre që shërbenin në ushtri, studimi i defterëve kadastralë ka treguar se ndarja e timareve, përveç atyre të karakterit ushtarak u bëhej edhe të tjerëve në bazë të kontributit që ata jepnin për shtetin.<sup>38</sup> Parë nga ky aspekt mund të kuptohet më së miri fakti se midis poseduesve të timarit përveç pashallarëve, spahinjve e rojeve të kalave ka edhe kadilerë, imamllarë,

<sup>34</sup> Shih: H. İncalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. 187, 208; gjithashtu shih: P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt...*, f. 359.

<sup>35</sup> “Tu dha si shtesë mbi sanxhakun e Shqipnisë Jakup Beut, bir i Todor Muzakës.” Shih: *AIH, A-III-323, Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 3.

<sup>36</sup> Për më shumë të dhëna mbi pjesët e timarit shih: H. İncalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXXI-LV.

<sup>37</sup> Përveç botimeve të shumta që i janë bërë në gjuhën turke, kanunaveja në fjalë është botuar edhe në shqip duke u ardhur në ndihmë studiuesve vendas që merren me këtë temë. Përveç kanunavesë në fjalë studiuesi Egro ka sjellë në gjuhën shqipe edhe kanunave të tjera që u përkasin sanxhaqeve shqiptare dhe atyre me shumicë shqiptare. Për më shumë shih: D. Egro, *Ligji osman ndër shqiptarë...*, f. 49.

<sup>38</sup> Për më shumë të dhëna mbi kategoritë e tjera që përfitonin nga ndarja e timareve, porse profesioni i tyre nuk lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimin ushtarak, shih: N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Tımar...*, f. 34-43.

priftërinj, sekretarë (jazixhi), stallierë (mir-ahur) ku, një ndarje të tillë e vërejmë edhe në Defterin e Përmetit dhe të Korçës çka tregon se mes përfituesve të timareve janë edhe ata persona puna e të cilëve lidhej me detyra që i shërbenin jetës komunitare e asaj shpirtërore.

Ashtu edhe si në regjistrat e tjerë kadastralë edhe këtu timaret janë shënuar nga më të mëdhatë që u përkisnin sanxhakbejlerëve për të vijuar më pas me subashët, seraskerët, dizdarët, kadilerët, myselemët, vojnikët e me radhë nëse ka të tillë në zonën ku është bërë regjistrimi. Në Defterin e Përmetit dhe të Korçës nuk kemi një të dhënë mbi timarin e sanxhakbeut për vetë faktin se mungesa e faqeve të para na e pamundëson mësimin e këtij aspekti dhe se defteri nis me timaret e rojeve të Kalasë së Konicës.<sup>39</sup>

Sipas Tayyip Gökbilgin në periudhën në fjalë kemi hasë perandorake në pjesë të Rumelisë<sup>40</sup>, por si në sanxhakun Arvanid ashtu edhe në regjistrin e Përmetit dhe të Korçës nuk e vërejmë ekzistencën e timareve të tilla. Nisur nga kjo që thamë më sipër por edhe nga mungesa e fletëve të para çka na pamundësojnë të mësojmë nëse në këtë njësi administrative kishte hasë të vezirëve, pashallarëve apo funksionarëve të lartë të shtetit, në defterin tonë timaret më të mëdhenj janë ato që iu përkasin subashëve të Përmetit dhe të Korçës ku timari i të parit, Sunkurxha Beut kap shifrën e 33458 akçeve ndërsa haset e subashit tjetër i kalojnë 40 mijë akçet.<sup>41</sup>

Termi *has*, ashtu si në regjistrat e tjerë të kësaj periudhe, edhe këtu përmendet bashkë me timaret e mëdhenj. Në defterin e Përmetit dhe të Korçës atë e hasim vetëm në rastin e subashit të Përmetit dhe atë të subashit të Korçës i cili në regjistrin tonë vërejmë që ka mbetur mevkuf.<sup>42</sup> Ndërsa fjala *ziamet*, ashtu si në defterin e sanxhakut Arvanid edhe këtu nuk kalon. Ashtu si në regjistrat e ngjashëm edhe këtu *kist-i bazar* vërehet tek subashët e Përmetit dhe të Korçës, çka nënkupton se si në Përmet ashtu edhe në Korçë kishte tregje lokale. E njëjta gjë ndodh edhe në rastin e *nijabet-i vilajet* që e hasim në Mborje ku mësojmë se ka edhe një treg. Sipas regjistrin në fjalë, taksa e vjelur prej *kist-i bazar* së bashku me atë të *nijabetit*, kap shifrën e 10045 akçeve.<sup>43</sup>

<sup>39</sup> Shih: *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 1.

<sup>40</sup> Gökbilgin, *Edirne ve Paşa Livası...*, f. 73.

<sup>41</sup> *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 5, 42.

<sup>42</sup> Për më shumë shih: *Po aty*, f. 42.

<sup>43</sup> *Po aty*.

Regjistrimet e kryera në këtë defter dhe ndarja e timareve paraqesin ndryshime të mëdha nëse do të krahasohen me ndarjen e timareve në bazë të të ardhurave ku timaret e dhëna tek ata që do të shërbenin në ushtri fillonin nga shifra e 1000-2000 akçeve në vleftën e të ardhurave vjetore.<sup>44</sup> Por, në rastin e regjistrimeve të kryera në zonat e Përmetit dhe të Korçës vërejmë ekzistencën e disa timareve të ardhurat e të cilëve janë nën vlerën e 1000 akçeve.<sup>45</sup> Kjo lidhet me terrenin tejet të vështirë gjeografik të këtyre zonave por edhe me gjendjen e dobët ekonomike të hapësirës së marrë nën regjistrim. Ky element evidentohet edhe nga fakti se nëse do të krahasojmë të ardhurat e timareve të këtij regjistri me ato të regjistrimit të sanxhakut të Arvanidit që është përpiluar në të njëjtën kohë, të ardhurat e timarlinjve të defterit të dytë janë më të larta se ato të zonave të Përmetit, Korçës dhe hapësirës përreth tyre.

Ashtu si në defterin e sanxhakut të Arvanidit edhe në këtë regjistër hasim në një numër të konsiderueshëm timarësh të cilët janë në duart e të krishterëve. Siç duket edhe nga shënimet, timaret në fjalë duket se janë dhënë në kohët e hershme të vendosjes së regjimit të timarit në këto zona. Me kalimin e kohës, vërejmë se, timaret në fjalë janë tjetërsuar duke u dhënë tek timarlinj të rinj të cilët i përkasin besimit islam.<sup>46</sup> Gjithashtu, ka edhe raste kur timari i mbetet sërish poseduesit të krishterë porse për mbajtjen e pronës vërejmë se kanë hyrë pasardhësit e mbajtësit të hershëm të timarit që tanimë janë myslimanizuar, siç e shohim në rastin e timarit të Mesir Pavlit.<sup>47</sup>

Nga ana tjetër, timaret më të mëdha dhe njëkohësisht ato më të rëndësishmet vërejmë se iu janë dhënë funksionarëve të cilët në shumicën

<sup>44</sup> Lidhur me të ardhurat dhe kategoritë e timareve shih: N. Beldiceanu, *Osmanlı Devletinde Timar...*, f. 46-47; H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXXI, XXXIII-XXXIV.

<sup>45</sup> Për shembull timari i Didos, Meladinit dhe i Gjon Nazhës të cilët e kishin marrë këtë vend për ta gjallëruar kishte gjithsejt një shumë të ardhurash vjetore prej 515 akçesh. Shih: *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 52.

<sup>46</sup> Si shembull mund të jepet timari i Zhupanit për të cilin lexojmë këtë shënim: “*Timari i Zhupanit, është timarli i vjetër. I qe marrë timari i parë që e kishte poseduar prej kohësh duke ju dhënë një pjesë kadiut dhe një pjesë Tejlu - Hysenit. Timari i sipërm i ri, i është dhënë të lartpërmendurit nga tahvili i Ismailit, ka në dorë beratin e sulltanit.*” Shih: *Po aty* f. 13.

<sup>47</sup> “*ky është timar i hershëm (kadimi). Me anën e djalit të vajzës së tij, Muhammediut, mori berat nga sulltani i tanishëm. Por sot (këtë) timar e kanë në zotërim të përbashkët tre vetë: Pavli, i biri dhe Muhammediu.*” Shih: *Po aty*, f. 23.

e rasteve janë të ardhur nga vende të tjera të Perandorisë Osmane, mes të cilëve shohim se ka një pjesë të konsiderueshme që e kanë ndryshuar besimin duke u bërë integruar brenda kastës sunduese. Në regjistrin tonë shembuj të ngjashëm paraqesin timaret e Jaku Beut (Muzakës) apo edhe i Arnavud Doganit, i cili mësojmë se ishte i biri i Ostojos dhe në vitin Hixhri 841 (1437-1438) zotëronte postin e sanxhakbeut të Ternovit.<sup>48</sup> Por, kemi edhe timare të tjera të rëndësishme që iu janë dhënë timarlinjve të krishterë të cilët kryesisht kishin detyra si ruajtës kalaje, derbendxhinj, ejt. Si shembull këtu mund të jepet timari i Kushtës për të cilin vërejmë këtë shënim: “*Timari i Kushtës: (vdekur) në fillim këtë fshat e gëzonte një kështjellar, por fshati qe shpërndarë. Kushtës së lartpërmendur Pashai i dha biti me kusht që ta gjallëronte dhe të bënte roje në postën -kufitare (derven) të Korçës. Ky e ringjalli. Prandaj mori edhe një biti tjetër nga Pashai me anën e së cilës ai bëhet eshkinxhi.*”<sup>49</sup>

Timare të tjera që tërheqin vëmendjen në regjistrin e Përmetit dhe të Korçës janë edhe ata të cilat u ishin dhënë klerikëve. Këtu vend të rëndësishëm zënë personat që kryejnë profesionin e imamit për të cilët janë ndarë timare që mund të konsiderohen si një shpërblim apo pagesë kundrejt shërbimit dhe kontributit që këta klerikë japin. Në regjistrin tonë ka dy timare që iu janë dhënë imamëve<sup>50</sup> porse defteri ka edhe shumë fshatra e truallishte të cilat janë shpërndarë në formën e hisseve tek imamët që shërbenin në kala të ndryshme apo në qytetet e Përmetit dhe të Korçës. Si shembull këtu mund të japim fshatin Izgari, i cili merret prej timarit të Sunkurit dhe i jepet në formën e hisses imamit të emëruar në Përmet.<sup>51</sup>

Ndarje të ngjashme të timareve kemi edhe për pjesëtarët e klerit të krishterë. Në këtë rast, jo si tek ata të besimit islam të cilëve iu shtoheshin timaret porse si ruajtje të atyre çka kishin patur më herët. Nëse një pronë i përkiste mitropolisë, edhe gjatë kohës kur këto toka apo fshatra kanë kaluar në duart e osmanëve vërejmë se ata e kanë respektuar elementin e besimit duke j’ua lënë sërish priftërinjve administrimin e tyre. Megjithatë, këtu vlen të theksohet fakti se timaret e kadilerëve e imamllarëve ashtu si edhe ato të peshkopëve në konsideratën e osmanëve

<sup>48</sup> Shih: *Po aty*, f. 88.

<sup>49</sup> *Po aty*, f. 59.

<sup>50</sup> Përkatësisht timari i Nefesit dhe i Mesud Fakihut (i dyti me profesion imam) dhe timari i Ahmed Fakihut. Shih: *Po aty*, f. 38, 117.

<sup>51</sup> *Po aty*, f. 14.

gëzonin një status të veçantë. Tek to gjejmë shënime si “e kanë përdorur kadilerët e mëparshëm” çka tregon qasjen e tyre karshi mbajtësve të timareve në rastin kur këta ishin klerikë. Nga këto argumente, edhe Inalcık shprehet se timaret e ngjashme qëndronin po në të njëjtin status, porsì haset e sanxhakbejlerëve apo të subashëve.<sup>52</sup> Në fakt, argumentimin në fjalë e mbështet edhe një rast i ngjashëm të cilin e vërejmë në defterin tonë. Kështu, në regjistrin e Përmetit dhe të Korçës hasim në timarin e Peshkopit për të cilin përpiluesi thekson se ky timar ka qenë poseduar vazhdimisht prej peshkopëve qysh në kohët e hershme dhe se ata kishin në duar berate lidhur me këtë të drejtë që gëzonin.<sup>53</sup> Megjithatë në periudhat e mëvonshme do të vërejmë që edhe në këtë timar do të ketë ndryshime.

Një term tjetër që na del përpara në sistemin e ndarjes së timareve është edhe *hisse* e cila në gjuhën tonë mund të përkthehet si “pjesë” dhe i referohet një pjese të timarit, e cila mund të jetë një fshat ose edhe më shumë.<sup>54</sup> Sigurisht që poseduesi i hisses e gëzon këtë të drejtë vetëm me marrjen e një berati dhe ashtu siç e shfrytëzon pjesën përkatëse të timarit gjithashtu duhet edhe të shlyejë detyrimet karshi shtetit – që nënkuptonte pjesëmarrjen në fushatat ushtarake- në bazë të të ardhurave që vjel nga *hisse*-ja e tij. Një term tjetër që lidhet me hissen është edhe fjala *mushterek* çka nënkupton shfrytëzimin e një timari prej dy ose më shumë personash. Në këtë kontekst, Defteri i Përmetit dhe Korçës ka në brendësinë e tij një numër të konsiderueshëm timarësh të përbashkëta ose të ndarë në pjesë, fenomen ky që lidhej si me aspektin gjeografiko-ekonomik të territoreve të marra nën regjistrim ashtu edhe me metodat që osmanët ndiqnin për t’u vendosur në zonat e pushtuara rishtazi.<sup>55</sup>

Në regjistër vërejmë timare që kanë qenë jashtë defterit (*haric-ez-defter*) e që janë gjendur e shënuar, ka shtesa (*zevaid*) të cilat janë shënuar për shkaqe të ndryshme që kanë të bëjnë me zbulimin e vendeve

<sup>52</sup> H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXXII.

<sup>53</sup> *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 54.

<sup>54</sup> H. Inalcık, *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit...*, f. XXXIII.

<sup>55</sup> Njëra ndër arsyet e ndjekjes së një metode të tillë të ndarjes së timareve në hisse kishte të bënte me faktin se në ato zona ku kishte potencial kryengritjesh timari ndahej midis disa personave për të parandaluar qenien e gjithë zonës në duart e një personi të vetëm, i cili do ta kishte më të lehtë për të mobilizuar njerëzit për rebelime. Ndërsa kur timari ishte i ndarë në disa pjesë potenciali i organizimeve të ngjashme minimizohej. Për më shumë shih: *Po aty*, f. XXXIII-XXXIV.

apo të ardhurave të pashënuara më herët, pjesë të dhëna në formën e shpërblimit, vende ose fshatra që gjenden në defterin e vjetër e që në vijim nuk i janë dhënë njeriu etj.<sup>56</sup> Të gjitha këto i gjejmë të shënuar në regjistër ku një element tjetër janë edhe fshatrat apo vendet të cilat kanë qenë të zbrazura apo të rrënuara e që më pas vërejmë se iu janë dhënë timarlinjve për t'i gjallëruar (*shenletme*) siç mund të jetë fjala për timarin e Andreas i cili kishte kërkuar të gjallërojë fshatin e quajtur Leshnicë që ishte rrënuar më herët me urdhër të sanxhakbeut të arvanidit, Is'hak Beut.<sup>57</sup>

### Përfundim

Si përfundim, vlen të theksohet fakti se Defteri i Përmetit dhe i Korçës ashtu si edhe ai i sanxhakut të Arvanidit janë burime të dorës së parë sa i përket gjendjes ekonomike e demografike të këtyre zonave në gjysmën e parë të shek. XV. Nisur nga të dhënat që përmban regjistri, studiuesit e kësaj periudhe e kanë të lehtë të kuptojnë jo vetëm situatën ekonomike të Korçës, Përmetit dhe zonave të tjera të mbajtura nën regjistrim por edhe aspekte të toponimisë e etnisë së popullsisë së këtyre rajoneve. Për më tepër, si regjistri i sanxhakut Arvanid ashtu edhe ai i Përmetit dhe Korçës janë shembujt më të hershëm të sistemit të timarit dhe aplikimit të tij në nivelin institucional në të gjithë Perandorinë Osmane. Kjo bëri që historianë nga e gjithë bota që kishin si fushë studimi periudhën e hershme të shtetit osman në një mënyrë a në një tjetër të futeshin edhe tek historia e Shqipërisë përmes hulumtimit të regjistrave kadastralë që përmendëm.

Regjistri gjithashtu mbart rëndësi për të kuptuar dekadat e para të vendosjes së sundimit osman në këto hapësira dhe metodat që ata ndoqën karshi popullatës vendase. Këtu futen ndarja e timareve midis elitave të vjetra dhe atyre të reja, timarlinjtë e ardhur nga vende a gjeografi të tjera, karakterin fetar të popullsisë dhe timarlinjve që u vendosën etj. Shënimit e timareve që i përkasin periudhës së Sulltan Jilldirim Bajazidit në të

<sup>56</sup> Shih: *Po aty*, f. XXXV.

<sup>57</sup> Shënimi në tekst për timarin në fjalë është: “*Kur Is'hak Beu ishte sanxhakbej i Shqipërisë pat urdhëruar që ky fshati Leshnicë të sulmohej dhe të shkatërrohej. Tashti po e kërkon jomyslimani i lartpërmendur që ta gjallërojë përsëri.*” Shih: *AIH*, A-III-323, *Defteri i Përmetit dhe i Korçës...*, f. 50. Gjithashtu në të njëjtin regjistër fshatrat dhe vendet e gjallëruara vërehen edhe në faqet nr. 29, 45, 52, 53, 59, 60, 86, 94, 99, 101, 106, 107, 108, 109, 111.


njëjtën kohë janë edhe shenjat më të hershme të vendosjes së sistemit të timarit dhe të sundimit osman në këto zona për të vijuar më pas drejt të gjithë hapësirave të banuara prej shqiptarëve.

Mungesa e fletëve të para të këtij regjistri duket se do të lërë përgjithnjë, të paktën deri në një kopje tjetër të mundshme të të njëjtit defter ose të dhëna të tjera dokumentare që mund t'u japin përgjigje këtyre pyetjeve të hapura, disa çështje e pyetje si: defteri në fjalë ishte një njësi administrative më vete apo ishte pjesë e sanxhakut Arvanid? Nëse ishte më vete, atëherë pjesë e cilit sanxhak ishte dhe cilat zona përfshinte? Pavarësisht këtyre aspekteve të pandriçuara Defteri i Përmetit dhe i Korçës mbetet njëri ndër burimet më të hershme të hapësirave shqiptare nën sundimin osman në përgjithësi e të zonave juglindore në veçanti.

### *S u m m a r y*

#### THE CADASTRAL REGISTER OF PËRMET AND KORÇA AS A SOURCE FOR THE HISTORY OF SOUTHEASTERN ALBANIA DURING THE FIRST HALF OF 15<sup>TH</sup> CENTURY

The purpose of this essay consists in the presentation of the timar register for the regions of Përmet, Korça, Konica and Grebene. Compiled in 1431 (H. 835), together with *defter-i Sancak-ı Arvanid* they are considered as the earliest ottoman cadastral registers found until now. The defter is located in the Prime Ministry's Ottoman Archives (no. 321) and was translated into Albanian in 1968 by Vexhi Buharaja. The first pages of the register are missing. The absence of the first pages and some other elements such as the dates, handwriting of the writer and the regions taken under registration have been always a matter of discussion between the researchers regarding the fact that it was a different register from that of the *Sancak-ı Arvanid* or, they both were one register. However, the cadastral register of Përmet and Korça results as a primary source for the economical, political and social situation of Southeastern Albania during the first half of 15<sup>th</sup> and, also as an important document that shows the early implementation of the ottoman timar system.



Faksimile nga origjinali i Deferit për zonat e Përmetit e të Korçës